



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I GAZETARISË DHE I KOMUNIKIMIT



Programi: **Bachelor**

Drejtimi: **GAZETARI**

Lënda: Histori moderne

<i>Pedagogu:</i>	Dr. Andi Pinari
<i>Ngarkesa:</i>	2 ETCS (15 javë: 1.5 orë leksione në javë)
<i>Lloji i lëndës:</i>	me zgjedhje
<i>Viti/semestri:</i>	I/I

Përshkrimi: Që nga Revolucioni Francez i vitit 1789 qytetërimi perëndimor hapi një epokë të re në zhvillimin historik duke transformuar përgjithmonë të gjitha elementët e mëparshëm politik, ekonomik dhe social. Nga njëra anë liberalizmi filloi të përparonte gradualisht duke u ndeshur me konservatorizmin dhe duke bashkëpunuar herë pas here me nacionalizmin. Nga ana tjetër revolucionet industriale sollën një zhvillim të panjohur më parë në shoqëri dhe në konkurrencën ndërkombëtare. E gërshetuar me idetë nacionaliste, konkurrenca solli edhe konflikte të përmasave botërore duke lënë gjurmë të thella. Shfaqja e ideologjive të ekstremit të majtë dhe të djathtë solli përshtjellime të tjera duke aktivizuar modelin totalitar i cili përfundoi në rang evropian në vitin 1989.

Temat e leksioneve:

1. Hyrje. Revolucioni Francez i vitit 1789 dhe trashëgimia e tij në Evropën e shekullit të XIX. Epoka e Napoleon Bonapartit. Kongresi i Vjenës dhe vendimet e tij.
2. Lindja e ideologjive politike moderne: liberalizmi, konservatorizmi, nacionalizmi dhe romantizmi. Liberalizmi dhe revolucionet liberale. Revolucioni i 1830 në Francë dhe revolucionet e vitit 1848 në Evropë.
3. Revolucioni industrial dhe zhvillimet e reja ekonomike. Doktrina e liberalizmit klasik
4. Evolucionin e modelit liberal të shtetit në Britaninë e Madhe. Evolucionin e drejtës së votës. Konservatorizmi dhe përhapja e tij. Modeli bonapartist në Francë dhe fundi i tij.
5. Bashkimi kombëtar në Gjermani dhe Itali. Imperializmi perëndimor i fundit të shekullit të XIX.
6. Shkaqet e Luftës së Parë Botërore. Zhvillimi i luftës dhe frontet e saj. Konferenca e Paqes dhe rezultatet e Luftës së Parë Botërore.
7. Revolucioni rus i vitit 1917 dhe modeli i ri sovjetik. Kriza ekonomike e viteve 1929-1933. Kursi i Ri i Ruzveltit.
8. Vendosja e fashizmit në Itali. Politika e brendshme dhe e jashtme e Musolinit. Nazizmi dhe përmbajtja e tij. Politika e brendshme dhe e jashtme e nazistëve. Lufta e Spanjës.
9. Shkaqet e fillimit të Luftës së Dytë Botërore. Zhvillimi i luftës dhe operacionet kryesore ushtarake. Përfundimi i luftës dhe rezultatet e saj. Fillimi i Luftës së Ftohtë.
10. Rimëkëmbja e Evropës në vitet 1945-1955. Plani Marshall, mrekullia ekonomike dhe shteti i mirëqënies sociale.
11. Bashkimi Sovjetik gjatë Stalinit. Ardhja e Krushovit dhe destalinizimi. Lufta e Ftohtë
12. Anglia, Franca dhe Gjermania perëndimore në vitet 1960-1990
13. Sh.B.A në vitet 1960-1990

14. Epoka e Gorbaçovit dhe ndryshimet në politikat e bllokut lindor.
15. Rënia e murit të Berlinit dhe fundi i Luftës së Ftohtë.

Forma e kontrollit dhe vlerësimit

- Angazhimi në seminare:	10% e notës
- Kontrolli përfundimtar: provim me shkrim	90% e notës
- Gjithsej:	100%

Literatura e detyrueshme për studentin:

- 1.R.Gurakuqi, *Historia e kohës së Re 2, Qytetërimi perëndimor 1775-1871*, Phoenix Shkodër 2001
2. W. Lakër, *Europa në kohën tonë 1945-1992*, Dituria, Tiranë 1996
3. Ll. Filo, G. Sala, I. Gashi, *Historia bashkëkohore*, Albatros, Tiranë 2009.

Literatura plotësuese:

- 1.E. Hobsbawn, *Epoka e ekstremeve*, Çabej, Tiranë 1997
2. N. Rich, *Diplomacia e fuqive të mëdha 1814-1914*, Toena, Tiranë 2006
3. P. Johnson , *Kohët moderne*, Apolonia, Tiranë 1996.
4. A. Mezini , *Shekulli i XX-të*, Duda, Tiranë 2007.
5. N. Rozenberg, L.E. Bërdzell, *Si u pasurua perëndimi, transformimi ekonomik i botës industriale*, Elena Gjika, Tiranë 1995.